

Nga: Dr. Bernard Tahirbegolli, Kordinaror i KosADA

Lënda: Raport i punës i KosADA, për periudhën Korrik-Dhjetor 2021

Me nënshkrimin e Kodit Botëror Antidoping, Komiteti Olimpik i Kosovës ka marr përgjegjësinë të krijoj organizatën antidoping në Kosovë dhe të monitoroj zbatimin e Kodit në Kosovë, duke I mundësuar sportistëve Kosovar pjesëmarrje të barabartë në garat në arenën vendore dhe ndërkombëtare.

Duke u bazuar në këtë është themeluar dhe funksionalizuar komisioni-Agjencia e Kosovër për Antidoping (KosADA) me misionin që të realizoj të gjitha aktivitetet antidoping në vend dhe me vizionin për një mjedis sportiv pa doping në Kosovë.

KosADA ka drejtuar dhe koordinuar të gjitha aktivitetet në lidhje me anti-dopingun duke siguruar që sportistët brenda vendit të marrin pjesë në ngjarje sportive pa doping.

KosADA është bërë përgjegjëse për kryerjen e të gjitha aspekteve të Kontrollit të Dopingut në vend.

Aktivitetet e saj kryesore gjate vitit 2021 kane përfshirë edukimin, kontrollin e dopingut, hulumtimin/investigimin, zhvillimin e kapaciteteve anti-doping dhe monitorimin e zbatimit të Kodit Botëror Anti-Doping.

Gjatë vitit 2021 KosADA ka mbledhur gjithësej 10 mostra për kontrollë të dopingut përmes mbështetjes nga granti i WADA për EERADO. Prej tyre, janë testuar 5 sportist meshkuj dhe 5 femra. Të gjitha mostrat ishim mostra të urines dhe janë mbledhur jashtë garave (out of competition).

Gjatë vitit 2021 janë realizuar seminarat dhe webinarat vetëdijësuese për antidoping me sportistët dhe stafin mbështetës nga institucionet sportive si në vijim:

Federata e Volejbollit e Kosoves – webinar online ne platformen Zoom

Federata e Minigolfit e Kosoves - webinar online ne platformen Zoom.

Federata e Golfit e Kosoves– webinar online ne platformen Zoom.

Federata e Basketbollit e Kosoves– webinar online ne platformen Zoom.

Federata e Triathlonit e Kosoves – seminari ne hotel Sonoma ne Fushe Kosove.

Federata e Mundje Krahu e Kosoves– webinar online ne platformen Zoom.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për antidopingun janë realizuar 4 takime online me udhëheqësit e EERADO nga Gjeorgjia, znj Tamar Svanishvili dhe z. Teimuraz Ukleba.

